

VIII/530
6700

HYLLI I DRITËS

Ubi Spiritus Domini, ibi libertas.
(II. ad Cor. III. 17).

VOTER
KULTURE
SHOYPTARE

3-4

Marc-Prill 1940 - XVIII.

VJETI XVI.

S H K O D E R

Abonimi per „HYLLI I DRITËS“

Shqypni	Nji numer	Fr. 0.80	Nji vjetë	Fr. 7.—
Itali	» »	» 0.80	» »	» 7.—
Nder vende tjera . .	» »	» 1.20	» »	» 10.—

Administratori: A. B. Dema

PERMBAJTJA

p. p. — Historija e nji vjeti	fq. 97
P. BENEDIKT DEMA — Per nji „Atlant Gjuhsuer“ të shqypes	» 110
Prof. FRANO ALKAJ — Libri XXIV i Iliadës	» 130
GELASIUS — Fjalori toponomastik	» 135
D. GASPER GURAKUQI — Zojzi — Gramshi	» 144
GJETO KOLA — Himara	» 149
P. D. KURTI — Kangë trimnije	» 161
P. M. SIRDANI — Mëndoret e Provincës Françeskane të Shqypnis	» 169
P. ANTON HARAPI — Valë mbi valë	» 176
Dr. P. GJON SHLLAKU — Dokumenta historije	» 182
CLEMENTINUS — Andrra në diell (rivista e shtypit)	» 187
BIBLOGRAFI — V.A. — „Prralla kombtare“	» 193
» BEN-DEA — Agjen. Turist. „DRIN“	» 194
» BEN-DEA — „Osman. Reichsgesch. u. balk. Volksgeschichte“	» 196
P. D. KURTI — Prralla. — Fash. 22	



HYLLI I DRITËS

E PERKOHSHME KULTURARE - LETRARE



Historija e nji vjeti

KY muej i Prillit qi është në të kryem, kje permbledhja e historis së nji vjeti të Shqypnis së ré, qi në nji perjudhë kaq të shkurtë ka pasë sistemimin e vet të ri e definitiv perkah Shteti e pertrajtimin e vet neper vepra vertë të madhnueshme e kolosare.

Mbas provësh së bâme e mbas perfundimesh aspak të bukra të vjetvet të mbrame, qi e bânë gjêjen aq të padurueshme, sa me i u kerenuë shi kësaj brëznije së Kombit t'a perpËjë në nji katastrofë të vertetë e me kohë të zhdukë edhe gjuhen e rracen shqyptare, na është mbushë mendja plotsisht se Shqypnija në gjêjen e ré të punvet ka gjetë drrasen e pshtimit. Tue hË kjo per të dyten herë në kuadrin e Perandoris së Romës, ka ndeshë edhe 'i herë në nji temel të shëndoshët, ka gjetë atë *ubi consistam*; e prej gjêjes mâ s' ultes të Shtetit, në të cillen gjindej ndermjet Shteteve tjera të Balkanit, â' kapë në nji pozitë mâ të naltueshme se e kanë Shtetet tjera e me kohë ka m'u bâ edhe mâ i perparuemi.

Bashkimi i jonë me Romë nuk është vetem nji ndodhje e sodit; e - pa prË këtË ngjarjet, qi permenden zakonisht, të kohvet të Çezarvet - edhe në kohen e mjesme neper veprimin e dy italkanvet të mdhaj, qi jânë edhe Shêjtent mâ të mdhajt e Italis, Benediktit prej Norcies e Françeskut prej Asizit, qi me rradhë shndrruen rojet e nderit e t' apostullimit mbi ketë token e bekueme t'onen, të Parët t'onë, sa mâ të shternguem qi mbaheshin per Romë, aq mâ teper dishmoheshin per shqyptarë e aq mâ teper u kapen në kulmin mâ të naltin e lumnis

